

Znj. Adriana Berberi është zgjedhur anëtare e Komisionit të Konkurrencës, me Vendimin nr.7, datë 29.01.2018 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Znj. Berberi ka kryer studimet universitare në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, dega Financë - Kontabilitet (1980). Ajo ka përfunduar studimet Master Shkencor “Studime Evropiane”, Universiteti i Tiranës (2006).

Ajo ka një karrierë profesionale 38 vjeçare në fusha dhe sektorë të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare. Fillimet e saj kanë nisur në sektorin bankar, si eksperte e investimeve në Bankën e Shqipërisë. Në vitet 1991 -1997, specialiste në Drejtorinë e Buxhetit, Ministria e Financave dhe më pas, Zv. Ministre e Financave dhe Zv. Ministre e Ekonomisë.

Znj. Berberi ka qenë gjithashtu edhe Drejtoresh e Kabinetit të Kryeministrit në periudhën shkurt – shtator 2002.

Znj. Berberi ka një eksperiencë të gjatë edhe në fushën e mësimdhënies, ku ajo është angazhuar si pedagoge e jashtme në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës (1986-1990) në lëndët: Analiza e veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjeve dhe Bazat e Ekonomisë.

Në vitin 2008 – 2013, ajo ka qënë titullare e lëndeve “Financat Publike” dhe “ Fiskaliteti”, si dhe në cilësinë e Administratores së Deleguar pranë IAL “ Universiteti Marin Barleti”.

Për periudhën 2013 – 2017, ajo kreu detyrën e Drejtoresh së Kabinetit të Ministres së Arsimit dhe Sportit.

Në eksperiencën e saj profesionale, ajo ka përfaqësuar shtetin shqiptar në institucione të ndryshme financiare, duke mbajtur detyrën e Zv.Guvernatores së Shqipërisë në BERZH, të Zv.Presidentes dhe Presidentes së Bordit në Bankën e Zhvillimit të Detit të Zi për periudhën 1997-2005.

Në periudhën 2013-2017, ka qënë Kryetare e Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe aktualisht është anëtare e këtij bordi. Ajo zotëron licencën e Kontabilistit të Miratuar dhe të Audituesit Ligjor.